



Republika e Kosovës  
Republika Kosova-Republic of Kosovo  
*Qeveria –Vlada-Government*

*Ministria e Industrisë, Ndërmarrësisë, Tregtisë dhe Inovacionit*  
*Ministarstvo Industrije, Preduzetništva, Trgovine i Inovacija - Ministry of Industry,*  
*Entrepreneurship, Trade and Innovation*

Agjencia për Investime dhe Përkrahjen e Ndërmarrjeve në Kosovë  
Agencija za Investicije i Podršku Preduzeča na Kosovu  
Kosovo Investment and Enterprise Support Agency

---

**Rishpallje - Thirrje publike për aplikim në stendën shtetërore të Kosovës në panairin  
“World In Paris 2026”**

30 prill – 11 maj 2026  
Adresa: Paris, Francë

Me qëllim të promovimit të kompanive shërbyese/prodhuese kosovare të sektorit të turizmit dhe trashëgimisë kulturore, gastronomisë, ushqimit, pijeve dhe produkteve higjienike, në gjetjen e tregjeve të huaja për eksport të produkteve dhe shërbimeve, Ministria e Industrisë, Ndërmarrësisë, Tregtisë dhe Inovacionit (MINTI) përmes Agjencisë për Investime dhe Përkrahjen e Ndërmarrjeve në Kosovë (KIESA) fton bizneset të aplikojnë përmes kësaj thirrje që të jenë pjesë e këtij aktiviteti ndërkombëtarë. KIESA mbulon shpenzimet e hapësirës ekspozuese, ndërtimin e stendës, regjistrimin e deri në 15 subjekteve pjesëmarrëse, shpenzimet e energjisë elektrike, pastrimin ditor, etj., ndërsa shpenzimet e udhëtimit, akomodimit, ushqimit, dërgimin e materialeve promovuese, etj. të subjekteve pjesëmarrëse do të merren përsipër nga vet subjektet pjesëmarrëse. Afati për aplikim për pjesëmarrje është deri më 21.04.2026. Dokumentet e plotësuara si në vijim do të konsiderohen për vlerësim.

1. Aplikacioni i plotësuar më të dhënat bazike të subjektit aplikues;
2. Dëshminë që subjekti aplikues është i regjistruar në Republikën e Kosovës (kërkohet: certifikata e regjistrimit me informatat mbi biznesin);
3. Kopjen e letërnjoftimit të personit të autorizuar të subjektit aplikues;
4. Vërtetimin nga gjykata që dëshmon që personi i autorizuar i subjektit nuk është nën hetime (kërkohet origjinali, jo me i vjetër se 30 ditë);
5. Deklaratën nën betim;

6. Vërtetimin e qarkullimit vjetor të subjektit aplikues për vitin fiskal 2024 dhe apo 2025 nga Administrata Tatimore e Kosovës (kërkohet: Gjendja e përgjithshme e deklarimeve dhe transaksioneve të tjera nga ATK); dhe
7. Vërtetimin tatimor të subjektit aplikues për obligimet e kryera ndaj ATK, jo më e vjetër se 90 ditë nga data e lëshimit.

Në mungesë të cilit do dokument të kërkuar në listën e mësipërme aplikacioni i subjektit aplikues do të diskualifikohet. Për këtë aktivitetet sipas kriterëve në vijim dhe vlerësimit të pikëve do të përzgjidhen 15 subjekte, nëse aplikojnë më shumë subjekte të përgjegjshme do të përpilohet edhe lista rezervë në mënyrë që të zëvendësohet sipas vlerësimit nëse ndonjëra kompani tërhiqet për çfarëdo arsye:

#### **Kriteret e vlerësimit:**

- Produktet që subjekti aplikues do të ju ofrojë blerësve potencial në panair, maksimum 10 pikë:
  - 1 pikë për 1 produkt
  - 3 pikë për 2 produkte
  - 5 pikë për 3 produkte
  - 7 pikë për 4 produkte dhe
  - 10 pikë për 5 e më shumë produkte.
- Njohja e gjuhëve të huaja dhe aftësitë prezantuese, maksimum 10 pikë:
  - Gjuhë Angleze 5 pikë
  - Gjuhë Frënge 4 pikë dhe
  - Gjuhë tjera 1 pikë.
- Materialet promovuese në gjuhët e huaja, maksimum 10 pikë:
  - Gjuhë Angleze 4 pikë
  - Gjuhë Frënge 4 pikë dhe
  - Gjuhë tjera 2 pikë.
- Shtetet ku janë eksportuar produktet e subjektit aplikues gjatë vitit 2025, maksimum 10 pikë:
  - Shtetet e BE-së 5 pikë
  - Shtetet e CEFTA-së 3 pikë dhe
  - Shtetet tjera 2 pikë.
- Certifikime ndërkombëtare të subjektit, maksimum 5 pikë:

- ISO 3 pikë dhe
- Certifikime tjera 2 pikë.
- Paraqitja e subjektit aplikues në panaire apo dhe B2B takime në 5 vitet e fundit, maksimum 5 pikë:
  - 1 deri në 3 panaire 3 pikë dhe
  - 4 deri në 6 panaire 5 pikë.
- Qarkullimi vjetor i subjektit aplikues gjatë vitit fiskal 2024 dhe apo 2025, maksimumi 10 pikë:
  - 0 - 500.000 euro 4 pikë
  - 500,001 – 1,000,000 euro 8 pikë dhe
  - > 1,000.000 euro 10 pikë.

Subjektet që dëshirojnë të aplikojnë për të marrë pjesë në panair duhet të shprehin interesimin e tyre duke plotësuar aplikacionin dhe ta dërgojnë bashke me dokumentet e tjera në mënyrë elektronike më së largu deri më 21.04.2026 në e-mail adresën: [Export.Kiesa@rks-gov.net](mailto:Export.Kiesa@rks-gov.net)

Në momentin e aplikimit subjekti pranon të gjitha përgjegjësitë, obligimet, kriteret dhe detyrat e parapara me legjislacionin në fuqi dhe kriteret e veçanta të parapara në këtë thirrje publike.

Informimi dhe pyetësori për shprehje të interesit mund të merren në MINTI-KIESA apo të shkarkohen nga faqet e internetit: [mint.rks-gov.net](http://mint.rks-gov.net) dhe [kiesa.rks-gov.net](http://kiesa.rks-gov.net) apo në e-mail adresën: [Export.Kiesa@rks-gov.net](mailto:Export.Kiesa@rks-gov.net)